



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 korrik 2019

Nr. ref.: RK 1393/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI156/18

Parashtrues

Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-16-0207-A0001-A0006 të 31 majit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović nga Beogradi, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët i përfaqëson Vlastimir Petrović, avokat nga Graçanica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-16-0207-A0001-A0006, të 31 majit 2018. Më 11 qershor 2018, vendimi ishte pranuar në postën në Beograd, dhe iu përçoll parashtruesve të kërkesës më 16 qershor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ua mohon të drejtën e tyre për një pjesë të 20% nga privatizimi i NSH “Metohija remont” nga Peja (në tekstin e mëtejme: NSH “Metohija remont”).
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 46 [Mbrotja e Pronës], si dhe nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 tetor 2018, Gjykata e pranoi kërkesën e parashtruesve.
7. Më 16 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Latifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 22 tetor 2018, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ai të dorëzojë autorizimin në Gjykatë që dëshmon se parashtruesit e kërkesës e kishin autorizuar atë për t'i përfaqësuar në Gjykatë.
9. Më 22 tetor 2018, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
10. Më 5 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin që Gjykata e kishte kërkuar nga ai.
11. Më 20 qershor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve të rastit

12. Më 14 korrik 2011, NSH "Metohija remont" ishte privatizuar.
13. Më 10 mars 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) shpalli listën e përkohshme të punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH "Metohija remont" (në tekstin e mëtejshëm: pjesa e 20%). Parashtruesit e kërkesës nuk ishin në atë listë.
14. Më 3 maj 2012, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve që kishin fituar të drejtën në pjesën e 20%. Parashtruesit e kërkesës nuk ishin as në këtë listë.
15. Më 23 maj 2012, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Specializuar), me këtë ankesë parashtruesit e kërkesës kërkuan që AKP-ja t'i përfshijë ata në listën e punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20%, duke pretenduar se ata janë diskriminuar për shkak se vendimi i AKP-së i vendos ata në një pozitë të pabarabartë, dhe se ata nuk ishin në gjendje të realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligjin në fuqi në Kosovë.
16. Më 23 gusht 2016, Kolegji i Specializuar, me Aktgjykimin C-II-12-0017 refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar, për shkak të mungesës së provave materiale, konkretisht të librezës së punës ose librit amzë të punëtorëve.
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Kolegjin e Apelit kundër aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar.
18. Më 31 maj 2018, Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin AC-I-16-0207-A0001-A0006, vërtetoi Aktgjykimin [C-II-12-0017] të Kolegjit të Specializuar, dhe në pjesën (A-0004 dhe A-0005) e arsytimit të aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, sa i përket parashtruesve të kërkesës, qëndron:

„Kolegji i Apelit konsideron që Kolegji i Specializuar ka vendosur drejtë kur ka refuzuar ankesën e tij si të pabazuar për shkak të mungesës së provave materiale siç janë librezat e punës ose libri amzë, me të cilët do të vërtetohej që parashtruesi i kundërshtimit ka qenë punëtor i NSH-së së përmendur. Kolegji i Apelit mendon që parashtruesi i kundërshtimit nuk ka dorëzuar dëshmi me të cilat vërteton që përmbushë kriteret të cilët janë përshkruar me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, në mënyrë që të jetë i përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të cilët realizojnë të drejtën në pjesën e pjesës së 20%.“

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e kontestuara janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
20. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të Konventës, parashtruesit e kërkesës për herë të parë në Gjykatë pretendojnë, *“që e drejta për barazi para ligjit, është shkelur në procedurën para AKP-së, procedurë në të cilën, si provë e vlefshme dhe relevante e ekzistimit të marrëdhënies së punës për punëtorë të shumtë të nacionalitetit shqiptar, ka qenë pretendimi që në këtë NSH kanë punuar deri në vitin 1990 ose 1991, si dhe që librezat e punës është shkatërruar. Madje, në procedurën para Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së për çështjet në lidhje me AKP-në, njëra nga provat materiale “Vërtetimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale” ka qenë e mjaftueshme për vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies së punës në raport me shqiptarët, dhe e pamjaftueshme për parashtruesit e kësaj kërkesë, edhe pse edhe periudha e përfshirë me Vërtetim ka qenë e njëjtë, mu e njëjtë si në rastin e parashtruesve të kërkesës”*. Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme për trajtim të pabarabartë, parashtruesit e kërkesës bashkëngjiten aktgjykimin AC-I-16-0207 të 31 majit 2018, duke theksuar arsyetimin lidhur me ankuesin A-0003 për F. M.
21. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës, parashtruesit e kërkesës theksojnë, *“Edhe pse me asnjë rregullore nuk është parashikuar që librezat e punës është dëshmi ekskluzive mbi ekzistimin e marrëdhënies së punës, kjo rrethanë është marrë si e vetmja dhe vendimtare e vlefshme. Në procedurën para AKP-së, si dhe para DHPGJS-së për çështjet në lidhje me AKP-në, me rregullore pozitive janë parashikuar që fakti i ekzistimit të marrëdhënies së punës, mund të dëshmohet me deklaratat e dëshmitarëve, por, diskutim me gojë nuk është mbajtur kurrë, në asnjërin nga procedurat e kryera, dhe në këtë mënyrë, paditësve nuk iu është dhënë mundësia për të provuar marrëdhënien e tyre të punës. Kjo, veçanërisht, duhet të vlerësohet, duke pasur parasysh mosekzistimin e dispozitës së Ligjit mbi AKP-në, me të cilin rregullohen rregullat e procedurës, si dhe që mu me këtë ligj, është përjashtuar zbatimi i procedurës së përgjithshme administrative.”*
22. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë, *“Parashtruesit e kërkesës theksojnë që edhe obligimet e NSH-së, si punëdhënës, dhe të atyre si të punësuar, kanë qenë të rregulluara me dispozitat e ligjit për punën e bashkuar dhe me nenin 219 të këtij ligji është përshkruar që në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të të punësuarit, është e domosdoshme të dorëzohet vendimi me shkrim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në të cilën theksohen arsyet e ndërprerjes dhe udhëzimet për mjet juridik. Vendimi i tillë me shkrim nuk i është dorëzuar fare parashtruesve të kërkesës, e nga dita e marrjes së kontrollit mbi NSH “Metohija remont”-in, as AKP-ja, e as udhëheqja e kësaj NSH-je pas qershorit 1999, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të*

kthimit të parashtruesve të kërkesës në punë. Këto fakte, mjaft qartë tregojnë që e drejta e tyre në punë është shkelur”.

23. Parashtruesit e kërkesës në vazhdim pretendojnë, *“Parashtruesit e kërkesës veçanërisht theksojnë që me parashtrimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit AC-I-16-0207 të 31.05.2018, nuk e shprehin pakënaqësinë e tyre me rezultatin e procedurës, por nga Gjykata Kushtetuese kërkojnë të vërtetojnë shkeljen e Kushtetutës në procedurat të cilat janë ndërmarrë lidhur me vërtetimin e të drejtave në pjesën e 20 % nga të ardhurat e realizuara me privatizimin e NSH-së “Metohija remont” nga Peja. Parashtruesit e kërkesës theksojnë që me lëshimet e vazhdueshme në shumë nivele, së pari nga ana e AKP-së, e pastaj edhe të DHPGJS-së për çështje që kanë të bëjnë me AKP-në, padyshim është penguar çdo e drejtë në gjykatë dhe vendim ligjor për të drejtën e parashtruesve të kërkesës dhe nevojën e mbrojtjes së asaj të drejte”.*
24. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që ta aprovojë kërkesën si të pranueshme dhe ta deklarojë të pavlefshëm dhe ta kthejë për rivendosje Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit [AC-I-16-0207-A0001-A0006] të 31 majit 2018, si dhe ta vërtetojë të drejtën e parashtruesve të kërkesës në 20% nga privatizimi i NSH “Metohija remont” nga Peja dhe të urdhërojë PAK që t’i përfshijë parashtruesit e kërkesës në listën përfundimtare të punëtorëve që kanë të drejtën në pjesën 20% nga privatizimi i NSH “Metohija remont”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

28. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

29. Sa i përket plotësimit të këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, dhe se kontestojnë një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I-16-0207-A0001-A0006, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë precizuar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendojnë se janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe kërkesën e kanë dorëzuar në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

30. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2), në veçanti përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

31. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës mund të reduktohen në:

(i) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së;

(ii) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe

(iii) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

(i) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së

A. Parimet e përgjithshme në lidhje me diskriminimin

32. Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thotë se “diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme” (shih: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 11 shtatorit 2002; *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006).

33. Në mënyrë që pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me diskriminimin të jenë të suksesshme, ata, *inter alia*, duhet të dëshmojnë se pozita e tyre mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e personave tjerë të cilët kanë pasur trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991).

B. Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastin konkret

34. Gjykata vëren se, në mbështetje të pretendimeve të tyre për diskriminim dhe trajtim të pabarabartë, parashtruesit e kërkesës theksojnë aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit në pjesën A-0003 lidhur me F.M. në të cilën pjesë F.M. i njihet e drejta për pjesën e 20% nga privatizimi i NSH-së "Metohija remont".
35. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se për Kolegjin e Apelit "*Vërtetimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*" ka qenë i mjaftueshëm për vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies së punës në raport me shqiptarët, dhe e pamjaftueshme për parashtruesit e kësaj kërkesë.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk paraqitën argumente bindëse për të mbështetur pretendimet e tyre se ata ishin trajtuar ndryshe nga Kolegji i Apelit në raport me palët në procedurë.
37. Gjykata ka analizuar në detaje aktgjykimin lartpërmendur të Kolegjit të Apelit dhe konstatoi se Kolegji i Apelit nuk "*ka vepruar ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme*".
38. Prandaj, Gjykata vëren se dokumenti kryesor si bazë për njohjen e të drejtave në rastin A003 (ankesa e F.M.) ishte dokumenti *kopja e librit amzë* të punonjësve lidhur me rastin A003 (ankesa e F.M.), ndërsa parashtruesit e kërkesës e dorëzuan një kopje të "*ekstraktit të kontributeve të përcaktuara*" të administratës së pensioneve, si dhe disa dokumente të tjera, por jo librezën e punës ose një ekstrakt të librit amzë të të punësuarve, që është dëshmi relevante për vërtetimin e marrëdhënies së punës në N.SH. "Metohija remont", siç ishte rasti A003 (ankesa e F.M.).
39. Në bazë të fakteve dhe sqarimeve të mësipërme, Gjykata konkludon se kemi rrethana të ndryshme dhe të drejta të ndryshme në krahasim me parashtruesit e kërkesës dhe punëtorit të lartcekur, të cilit i është njohur e drejta për pagesë të pjesës së 20% nga privatizimi i NSH „Metohija remont“.
40. Prandaj, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për diskriminim dhe trajtim të pabarabartë nga ana e Kolegjit të Apelit janë të pabazuara, pasi që Kolegji i Apelit nuk "*ka vepruar ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme*".

(ii) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

41. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se AKP-ja, si dhe Kolegji i Specializuar dhe i Apelit e kanë interpretuar gabimisht të drejtën materiale dhe se "*diskutimi me gojë nuk është mbajtur kurrë, në asnjërën nga procedurat e kryera, dhe në këtë mënyrë, paditësve nuk iu është dhënë mundësia për të provuar marrëdhënien e tyre të punës*".
42. Nga sa u tha më sipër, parashtruesit e kërkesës konkludojnë se atyre nuk u është ofruar mbrojtje adekuate e paraparë me ligj dhe kështu ka ardhur deri te

shkelja nga "neni 31 i Kushtetutës [...] lidhur me nenin 6. 1 (e drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së".

43. Gjykata përsërit që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara në aplikimin e ligjeve përkatëse që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih: *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, paragrafi 28 i Aktgjykimit të GJEDNJ-se, të 21 janarit 1999).
44. Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe i Apelit u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me arsyet e aplikimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.
45. Gjykata vëren se arsyeja kryesore për refuzimin e padisë së parashtruesve të kërkesës në Kolegjin e Specializuar dhe të Apelit ka qenë mosekzistenca e provave adekuate për të dëshmuar përvojën e tyre të punës në NSH "Metohija remont", fakt i cili është arsyetuar në aktgjykimin e kontestuar.
46. Duke sjellë paragrafët e mësipërm në lidhje me faktet e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në asnjë fazë të procedurës, nuk kanë kërkuar të ftohen dëshmitarët, të cilët do të ofronin dëshmi faktike ose prova të tjera gjatë procedurës me gojë duke deklaruar emrat e mbiemrat e tyre të plotë, siç parashihet në nenin 36, paragrafi 1, pika 2 të aneksit të Ligjit të DHPGJS-së, e drejtë për të cilën parashtruesit e kërkesës pretendojnë se atyre iu është mohuar.
47. Për më tepër, Gjykata vëren se as Kolegji i Specializuar e as Kolegji i Apelit nuk kanë mundur të merren me këtë çështje, sepse nuk ka pasur kërkesë zyrtare për dëgjim publik dhe dhënie të dëshmimeve të dëshmitarëve. Gjykata nuk e gjen një veprim të tillë të Kolegjit të Specializuar dhe të Apelit si të parregullt apo arbitrar, gjë që do të ishte në dëm të parashtruesve të kërkesës.
48. Prandaj, Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kanë respektuar detyrimin e tyre sipas nenit 31 paragrafi 1 të Kushtetutës dhe të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, dhe për këtë arsye janë të pabazuara pretendimet e parashtruesve të kërkesës që me vendimet e kontestuara është shkelur e drejta për gjykim të drejtë në atë segment.
49. Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesit e kërkesës nuk tregon se procedurat pranë Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesve të kërkesës iu është mohuar ndonjë garanci procedurale, që do të çonte në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht nenin 6 të KEDNJ-së.

(iii) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

50. Gjykata rikujton se parashtuesit e kërkesës gjithashtu theksojnë që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me lirinë e garantuar me nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës. Megjithatë, parashtuesit e kërkesës i arsyetojnë këto pretendime me shkelje të së drejtës për punë dhe përmendjes së normave ligjore që rregullojnë këtë fushë.
51. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003).
52. Parashtuesit e kërkesës më tej mund të pretendojnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuar kanë të bëjnë me “pronën” e tyre; brenda kuptimit të kësaj dispozite “pronë” mund të jetë “pasuri ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të të cilave parashtuesit e kërkesës mund të pretendojnë “prishmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimim efektiv të ndonjë të drejte të pronësore.
53. Nuk mund të thuhet se lind ndonjë “prishmëri legjitime” atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtuesat e parashtuesve janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecký kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).
54. Gjykata, duke i sjellë pretendimet e parashtuesve të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se parashtuesit e kërkesës nuk e kanë arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohen konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsiderojnë se kjo e drejtë është shkelur sepse Kolegji i Specializuar dhe ai i Apelit kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur për kërkesën e tyre për njohjen e të drejtës për pagesë të 20% nga privatizimi i NSH-së “Metohija remont”.
55. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 para. 1 të KEDNJ-së, Gjykata tashmë ka konkluduar se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në rastin konkret që tregon se parashtuesit kanë kërkesë të justifikuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës, dhe as nuk është e qartë që me aktgjykimet e kontestuar, parashtuesve të kërkesës u është mohuar realizimi i të drejtës së tyre.
56. Në përfundim, Gjykata konsideron se parashtuesit e kërkesës nuk kanë ofruar fakte që do të tregonin se vendimet e gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë kanë shkaktuar shkelje kushtetuese të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë.

57. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

